

VENDIM
Nr. 297, datë 5.4.2017

**PËR MIRATIMIN E NDRYSHIMIT 2 TË MARRËVESHJES, NDËRMJET KËSHILLIT
TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË
KONFEDERATËS SË ZVICRËS, PËR DHËNIEN E ASISTENCËS FINANCIARE PËR
PROJEKTIN E REHABILITIMIT TË KASKADËS SË LUMIT DRIN, MIRATUAR ME
VENDIMIN NR.508, DATË 24.10.1994, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, “PËR
MIRATIMIN E MARRËVESHJEVE TË GRANTIT TË NDËRTIMIT, NDËRMJET
QEVERISË SË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË DHE QEVERISË SË KONFEDERATËS
SË ZVICRËS, PËR PROJEKTET E REHABILITIMIT TË HIDROCENTRALEVE DHE
ZVOGËLIMIN E HUMBJEVE JOTEKNIKE NË ENERGJINË ELEKTRIKE”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 19 e 23, të ligjit nr.43/2016, datë 21.4.2016, “Për marrëveshjet ndërkombëtare në Republikën e Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Miratimin e ndryshimit 2 të marrëveshjes, ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës së Zvicrës, për dhënien e asistencës financiare për projektin e rehabilitimit të kaskadës së lumit Drin, miratuar me vendimin nr.508, datë 24.10.1994, të Këshillit të Ministrave, “Për miratimin e marrëveshjeve të grantit të ndërtimit, ndërmjet qeverisë së Republikës së Shqipërisë dhe qeverisë së Konfederatës së Zvicrës, për projektet e rehabilitimit të hidrocentraleve dhe zvogëlimin e humbjeve joteknike në energjinë elektrike”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTRI
Niko Peleshi

NDRYSHIMI 2

**I MARRËVESHJES NDËRMJET QEVERISË SË KONFEDERATËS ZVICERANE DHE
KËSHILLIT TË MINISTRAVE TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË PËR DHËNIEN E
ASISTENCËS FINANCIARE PËR PROJEKTIN E REHABILITIMIT TË KASKADËS SË LUMIT
DRIN**

Ky dokument përbën Ndryshimin 2 të Marrëveshjes së nënshkruar më 31 Tetor 1994 për Dhënien e Asistencës Financiare për Projektin e Rehabilitimit të Kaskadës së Lumit Drin ndërmjet Qeverisë së Konfederatës Zvicerane dhe Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë, të cilat më poshtë referohen si Palët.

Palët kanë rënë dakord të ndryshojnë vetëm pjesën e parë të Nenit 4.1 si më poshtë:

4.1 Kontributi i kalohet Korporatës Elektroenergjetike Shqiptare (KESH) si një kredi me interes zero e shlyeshme në valutën vendase në 5.5 këste të barabarta vjetore, kundrejt Ministrisë së Financave të Shqipërisë, pas një periudhe pa shlyerje prej 8 vitesh.

Të gjitha pjesët e tjera të Marrëveshjes së Projektit të lartpërmendur mbeten të pandryshuara. Ndryshimet nuk kanë ndikime të mëtejshme në aspektet e tjera të projektit të zbatuar.

Ky Ndryshim i Marrëveshjes hyn në fuqi pas njoftimit nga pala shqiptare se procedurat e brendshme ligjore vendase kanë përfunduar, të cilat lejojnë hyrjen në fuqi të Ndryshimit.

Nënshkruar në më, në dy kopje origjinale në gjuhën angleze dhe dy kopje

originale në gjuhën shqipe. Në rast mospërputhje, versioni në gjuhën angleze do të ketë përparësi.

PËR KËSHILLIN E MINISTRAVE TË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Ministria e Financave

Sh.e Tij, Arben Ahmetaj

Ministër

PËR KONFEDERATËN ZVICERANE

Ambasada e Zvicrës në Shqipëri

Sh.e Tij, Christoph Graf

Ambasador

AMENDMENT 2

TO AGREEMENT BETWEEN THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE REPUBLIC OF
ALBANIA AND THE GOVERNMENT OF THE SWISS CONFEDERATION ON THE
GRANTING OF FINANCIAL ASSISTANCE FOR THE DRIN RIVER CASCADE
REHABILITATION PROJECT

This document constitutes Amendment 2 to the Agreement signed on 31 October 1994 on the Granting of Financial Assistance for the Orin River Cascade Rehabilitation Project between the Government of the Swiss Confederation and the Council of Ministers of the Republic of Albania which are referred below as the Parties.

The Parties have agreed to modify only the first part of Article 4.1 as follows :

4.1 The Contribution shall be passed on to the National Company of Energy and Electricity of Albania (KESH) as a credit at zero interest repayable in local currency in 5.5 equal yearly installments to the Albanian Ministry of Finance, after a grace period of 8 years.

All other items of the above mentioned Project Agreement remain unchanged. The modifications have no further implications on other aspects of the implemented project.

This Amendment to the Agreement shall enter into force after the notification from the Albanian party that the domestic legal procedures have been completed which enable its entry into force .

Done at Tirana on the 20-th January 2017, in two originals in English and two originals in Albanian language. In case of divergence the English version shall prevail.

FOR THE COUNCIL OF MINISTERS OF THE
REPUBLIC OF ALBANIA

.....

Ministry of Finance
H.E. Arben Ahmetaj
Minister

FOR THE SWISS CONFEDERATION

.....

Embassy of Switzerland in Albania
H.E. Christoph Graf Ambassador